

AKT - THEMELIMI
I SHOQERISE "REDI-2004" SHPK TIRANE



NENI 1

SHKELQIM GOLLI i biri i Fejzullait dhe I Razijes, lindur ne 03.01.1972 e banues ne Rr"Donika Kastrioti"Nr.4,Tirane ,madhor,me zotesi te plote juridike per te vepruar,me kombesi e shtetesi shqiptare,

ZELFIJE GASHI e bija e Hazirit dhe Aishes ,lindur ne 16.10.1978 e banues ne Rr"Donika Kastrioti" Nr.4,,Tirane ,madhore,me zotesi te plote juridike per te vepruar,me kombesi e shtetesi shqiptare ,

Sot me dt. 16.01.2006 kemi vendosur me vullnetin tone te lire dhe te plote te krijojme Shoqerine me pergjegjesi te kufizuar te emertuar **"REDI-2004"** sh.p.k Tirane e cila do te rregullohet ne mbeshtetje te ligjes Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare", ligjit Nr.7667 date.28.01.1993,"Per rregjistrin Tregetar",si dhe te legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe normave qe vijojne:

NENI 2

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar e themeluar prej nesh eshte quajtur **"REDI-2004"** sh.p.k.Shoqeria **"REDI-2004"** sh.p.k eshte nje subjekt juridik shqiptar,te cilit i,lind e drejta te ushtroje aktivitetin qe nga data e rregjistrimit ne Rregjistrin Tregetar prane Gjykates se rrethit gjyqesor Tirane.Shoqeria **"REDI-2004"**zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe me aktet e themelimit te saj.

NENI 3

Shoqeria do te jete e formes se Shoqerive tregetare me pergjegjesi te kufizuar dhe perballon humbjet deri ne kufirin e vleres te kontributit te derdhur ne kapitalin themeltar.

NENI 4

Objekti i aktivitetit ekonomik te shoqerise do te jete: **Ne fushen e tregetimit me shumice dhe pakice,import – eksport te te gjitha mallrave industriale dhe ushqimore, kryesisht te mallrave te fushes se ndertimit,te veshmbathjes dhe mallrave ushqimore qofshin keto lende e pare,gjysme e perpunuar apo e gatshme.Ne fushen e ndertimit: ne Zbatim ;**

Kat.1.Germime dheu dhe punime eventuale,murature e beton arme – prishje dhe punime ne toke te germuar.

Kat.3.a.Ndertime civile,industriale,turistike,bujqesore deri 5 kate.

b.Ndertime civile,industriale,turistike,bujqesore,mbi 5 kate-Rikonstruksione.

Kat. 4.a. Ndertim rruge kategoria IV dhe V.

c. Punime te mirembajtjes dhe sinjalizimit ne rruge, ndertim mbishtresa rrugore.

Kat. 6.a. Ndertim ura dhe vepra arti deri 10 m.

Kat. 8.a. Ndertim ujesjellesa-kanalizime-kanale e impiante vaditese.

Hapje, hotelesh, bar e restorante, pika servisi per automjete, lavazhe etj. Transport mallrash e udhetaresh brenda dhe jashte Shqiperise.

NENI 5

Selia e shoqerise eshte ne Rr "Donika Kastrioti" Nr. 4, Tirane . Ajo ka te drejte te krijojë filiale, dege dhe perfaqesi ne te gjithë teritorin e vendit dhe jashte tij.

NENI 6

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke (nje qind mije leke), i derdhur dhe i shlyer teresisht nga ortakët e shoqerise, respektivisht.

SHKELQIM GOLLI
ZELFIJE GASHI

50.000 leke
50.000 leke

Shuma e derdhur per formimin e kapitalit themeltar do te vertetohet me ane te nje dokumenti te leshuar nga banka ose te depozitimit prane nje zyre noteriale.

I gjithë kapitali i vene nga ortakët themelues eshte teresisht dhe plotesisht i shlyeshem dhe i nenshkrueshem nga ana e tyre. Rritja e kapitalit themeltar te shoqerise nuk eshte e kufizuar.

NENI 7

Organet e shoqerise "REDI - 2004" sh.p.k. TIRANE jane:

* Asamblea e ortakeve te shoqerise.

* Administratori i shoqerise.

Modalitetet e formimit dhe funksionimit te tyre do te percaktohen ne statutin e shoqerise.

Administratore te shoqerise do te jene Z. SHKELQIM GOLLI dhe ZELFIJE GASHI.

NENI 8

Shoqeria tregetare private "REDI - 2004" sh.p.k TIRANE eshte person juridik shqiptar dhe do te ushtroje veprimtarine e saj ekonomike private ne baze te legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe vecanerisht ligjeve 7512 date 10.08.1991, 7638 date 19.11.1992, 7667



dt.28.01.1993,te K.Civil dhe te akteve te tjera ligjore dhe nenligjore te dala ne zbatim te tyre.

NENI 9

Kohezgjatja e aktivitetit te Shoqerise eshte e pakufizuar.

NENI 10

Mardheniet e punesimit ne shoqeri do te rregullohen nepermjet kontrates se punes qe lidhet midis paleve ne mbeshtetje te ligjit 7961 date 12.07.1995 (Kodi i Punes),si dhe te akteve te tjera ne zbatim te tij.

NENI 11

Mosmarveshjet e mundeshme qe mund te lindin gjate interpretimit apo zbatimit te ketij akti themelimi palet do ti zgjidhin ne rruge miqesore,ne te kundert kompetenca per zgjidhjen e konfliktit i kalon Gjykates se rrethit gjyqesor Tirane.

NENI 12

Per sa nuk pershkruhet ne kete akt themelimi do te aplikohen nenet e statutit te shoqerise dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

NENI 13

Akti i themelimit u perpilua ne kater kopje origjinale

Tirane me 16.01. 2006.

O R T A K E T

T H E M E L U E S

SHKELQIM GOLLI

ZELFIJE GASHI

Shkelqim Golli
SG

Zelfije Gashi
ZG

STATUTI

I SHOQERISE "REDI - 2004" SHPK TIRANE



Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "REDI - 2004" shpk, me seli ne Rr"Donika Kastrioti" Nr.4, Tirane, eshte krijuar sipas akt-themelimit te ortakeve themelues:

SHKELQIM GOLLI i biri i Fejzullait, lindur ne 03.01.1972 e banues ne Rr"Donika Kastrioti" Nr.4, Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, me kombesi e shtetesi shqiptare,

ZELFIJE GASHI e bija e Hazirit, lindur ne 16.10.1978 e banues ne Rr"Donika Kastrioti" Nr.4, Tirane, madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar, me kombesi e shtetesi shqiptare,

Statuti eshte akti baze ku do te mbeshtetet themelimi i shoqerise tregetare private "REDI - 2004" sh.p.k si dhe zhvillimi i metejshe i veprimtarise se saj.

Per te bere te mundur veprimtarine ekonomike dhe organizimin e kesaj shoqerie ne perputhje me ligjin 7512 date 10.08.1991, 7638 date 19.11.1992, si dhe Nr.7667 date 28.01.1993 eshte perpiluar ky statut me kerkesat e ligjes per shoqerite tregetare me pergjegjesi te kufizuar.

NENI 1

EMERTIMI

Shoqeria eshte quajtur "REDI - 2004" sh.p.k.
Ajo eshte nje subjekt shqiptar, te cilit i lind e drejta te ushtroje aktivitetin privat qe nga data e rregjistrimit ne Rregjistrin Tregetar prane Gjykates se rrethit gjyqesor Tirane. Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe aktet e themelimit te saj.

NENI 2

OBJEKTI

Objekti i aktivitetit ekonomik te shoqerise do te jete: **Ne fushen e tregetimit** me shumice dhe pakice, import - eksport te te gjitha mallrave industriale dhe ushqimore, kryesisht te mallrave te fushes se ndertimit, te veshmbathjes dhe mallrave ushqimore qofshin keto lende e pare, gjysme e perpunuar apo e gatshme. **Ne fushen e ndertimit: ne Zbatim;**

Kat. 1. Germime dheu dhe punime eventuale, murature e beton arme - prishje dhe punime ne toke te germuar.

Kat. 3. a. Ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore deri 5 kate.

b. Ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore, mbi 5 kate-Rikonstruksione.


Kat. 4. a. Ndertim rruge kategoria IV dhe V.

c. Punime te mirembajtjes dhe sinjalizimit ne rruge, ndertim mbishtresa rrugore.

Kat.6.a.Ndertim ura dhe vepra arti deri 10 m.

Kat.8.a.Ndertim ujesjellesa-kanalizime-kanale e impiante vaditese.

Hapje hotelesh,bar e restorante,pika servisi per automjete,lavazhe etj.Transport mallrash e qehetaresh brenda dhe jashte Shqiperise.

NENI 3

SELIA

Shoqeria "REDI - 2004" e ka seline ne Rr"Donika Kastrioti"Nr.4, Tirane.Ajo ka te drejte te krijoje brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise filiale,agjenci,perfaqesi etj dhe ti suprimoje ato.Cdo ndryshim i selise se shoqerise do te behet me vendim te Asamblese se Ortakeve.

NENI 4

KOHEZGJATJA

Shoqeria do te kete nje kohezgjatje per nje periudhe kohe te pakufizuar.Ajo mund te shperbehet ne cdo kohe me vendim te Asamblese se Ortakeve.

NENI 5

KAPITALI

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke (nje qind mije leke),i derdhur dhe i shlyer teresisht nga ortaket e shoqerise,respektivisht.

SHKELQIM GOLLI	50.000 leke
ZELFIJE GASHI	50.000 leke

Shuma e derdhur per formimin e kapitalit themeltar do te vertetohet me ane te nje dokumenti te leshuar nga banka ose te depozitimit prane nje zyre noteriale.

I gjithe kapitali i vene nga ortaket themelues eshte teresisht dhe plotesisht i shlyeshem dhe i nenshkrueshem nga ana e tyre.Rritja e kapitalit themeltar te shoqerise nuk eshte e kufizuar.

NENI 6

Ortaket e shoqerise zoterojne :

SHKELQIM GOLLI	50% te kuotave te kapitalit
ZELFIJE GASHI	50% te kutave te kapitalit

NENI 7



Transferimi i kuotave te kapitalit behet vetem me akt noterial. Kuotat e kapitalit jane lirisht te transferueshme. Ne rast shitje te kuotave te kapitalit, ortaku qe do te shese kuotat e tij, eshte i detyruar qe fillimisht te ia ofroje per shitje ortakut tjeter (ose ortakeve te tjere nese ka te tille) te shoqerise. Nese keta te fundit nuk deshirojne te blejne kuotat objekt shitje, ortakut shites mund ti shese kuotat tek te tretet me te njejtin cmim qe iu ofroi ortakeve ose me nje cmim me te larte por asnjehere me cmim me te ulet.

NENI 8

Shoqeria mund te rrise kapitalin themelor, ose mund ta zvogeloje ate, por gjithnje jo nen kufirin e 100.000 leke-ve, qe percaktohet ne ligjin 7638 dt. 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare". Shtimi dhe pakesimi i kapitalit behet me vendim te Asamblese se ortakeve dhe sipas kerkesave te ligjes.

NENI 9

Pjeset e kapitalit themelor jane plotesisht te transferueshme ne rruge trashegimmie, ne rast ndarje pasurore ndermjet bashkeshorteve, paraardhesve dhe pasardhesve.

Ne rast vdekje te ortakut pjeset e kapitalit themelor qe disponon i kalojne trashegimtareve te tij. Trashegimtari hyn ne shoqeri me te gjitha te drejtat e detyrimet perkatese te ortakut.

Ne rast se asnjeri nga trashegimtarete nuk pranon te punoje ne ortakeri, atehere ata jane te detyruar te shesin pjesen e kuotave te kapitalit qe trashegojne, ne favor te ortakut tjeter te shoqerise (apo ortakeve te tjere ne se ka te tille), me vleren e tyre nominale. Pas shitjes se kuotave, trashegimtareve u jepen te gjitha fitimet qe iu takojne sipas kontributit te derdhur ne kapitalin themelor nga ortakut i vdekur, trashegimlensesi i tyre.

NENI 10

Cdo ortak qe kryhen akte qe diskretitojne aktivitetin e shoqerise dhe figuren morale te tij, eshte i detyruar te shese ne favor te ortakut tjeter pjesen e tij te kuotave te kapitalit me vleren e tyre nominale dhe pjesen e tij te pasurise qe i takon ne shoqeri deri ne ditën e kryerjes se aktit diskretitues, me vleren e pasyruar ne bilancin e shoqerise.

Nese shoqeria do te perbehet nga me shume se dy ortake, shitja e kuotave dhe pasurise si me siper do ti ofrohen per blereje me pare, ortakut qe ka pjesen me te madhe te kuotave ne shoqeri. Nese ky ortak nuk do te deshiroje te bleje pjesen e ofruar per shitje, ajo do tju ofrohet ne te njejten menyre ortakeve te tjere duke respektuar pjesen me te madhe. Nese do te mbetet per tu blere nga ortake me pjese te barabarta, blerja do te behet me konsensus mes te barabarteve.

Nese asnjeri nga ortaket nuk do te deshiroje te bleje pjesen e ortakut qe ka kryer aktin diskretitues, ky i fundit mbetet ne shoqeri.

NENI 11



Fitimi i realizuar nga ushtrimi i veprimtarise ekonomike te shoqerise do te administrohet nga ortaket e shoqerise. Nje pjese e ketij fitimi mund te perdoret per zgjerimin e aktivitetit tregetar. Shoqeria eshte e detyruar te shlyej te gjitha detyrimet qe ka ndaj shtetit dhe te treteve.

NENI 12

Organet drejtuese te shoqerise jane :

Asamblea e Ortakeve

Administratori i shoqerise.

Asamblea e ortakeve eshte organi vendimor i shoqerise. Ajo mund te jete e zakonshme ose e jashtezakonshme. Asamblea e zakonshme thirret te pakten dy here ne vit, pas mbylljes se vitit financiar dhe kur aprovohet programi i veprimtarise per vitin e ardhshem.

Asamblea e jashtezakonshme thirret kur administratori i shoqerise e quan te pershtatshme per kerkesat e shoqerise. I takon asamblese se jashtezakonshme te beje ndryshime ne Statutin e Shoqerise ,te pakesoje ose shtoje kapitalin themeltar. Te shperndaje perpara afatit shoqerine, ose te shtyje aktivitetin e saj. Nese shoqeria perbehet vetem nga nje ortak, atributet e asamblese se ortakeve i gezon ortaku i vetem i saj

NENI 13

Asamblea e ortakeve drejtohet nga Administratori i shoqerise. I takon ketij te fundit te verifikoje rregullsine e pjesmarrjes se ortakeve. Cdo ortak mund te perfaqesohet ne asamble nga nje tjeter ortak me ane te nje akti me delegim te nenshkruar sipas firmes se depozituar ne librin e ortakeve.

Per te mbajtur procesverbalin e mbledhjeve te Asamblese caktohet nje sekretar, qe mund te jete dhe nje noter. Vendimet e asamblese duhet te nenshkruhen nga Administratori i shoqerise, nga sekretari dhe nga te gjitha pjesemarrësit. Vendimet e Asamblese te marra ne perputhje me ligjin dhe me kete statut jane te detyrueshme per te gjithë ortakët prezent ose jo. Organi administartor i shoqerise eshte Administratori i shoqerise. Ai zgjidhet nga Asamblea e ortakeve dhe qendron ne detyre per gjithë kohezgjatjen e aktivitetit, pervec rasteve te nje revokimi eventual nga vete Asamblea e ortakeve te shoqerise.

Administratore te shoqerise "REDI - 2004" sh.p.k Tirane do te jene Z.SHKELQIM GOLLI dhe ZELFIJE GASHI.

Drejtues teknik i shoqerise eshte Z.Elham Baruti.

NENI 14.

Administratorit te shoqerise i takon administrimi i zakonshem i shoqerise pervecse kur kjo gje sipas ligjes apo statutit i rezervohet Asamblese se ortakeve.

I takon Administratorit te shoqerise te perfaqesojë shoqerine perpara te treteve dhe ne gjykim. Ai gezon te drejten e firmes se shoqerise. Administratori i shoqerise perjashtohet nga e drejta e marrjes se kredive bankare, nga aktiviteti ne fushen e investimeve dhe berja e shpenzimeve tej aktivitetit te zakonshem te shoqerise.



Administratori mund ti delegeje te drejtat e veta nje personi te trete te autorizuar me shkrim per te perfaqesuar shoqerine si edhe te kryej veprime dhe praktika te ndryshme ne emer te tij

NENI 15

Asambleja e ortakeve te shoqerise ka keto kompetenca,per te marre keto vendime:

Te miratoje programin e veprimtarise se shoqerise,te hartoje raportet e administrimit,inventaret dhe llogarite vjetore.Vendos per shperndarjen e shoqerise,per ndarjen e fitimit dhe mbulimin e humbjeve.Rregullon mardheniet e punesimit dhe ato te shperblimit brenda shoqerise.Emeron dhe shkarkon administratore,eksperte kontabel.Ben ndryshime e plotesime ne statut dhe ne aktin e themelimit,vendos per rritjen ose zvoglimin e kapitalit themelor,kalimin e kapitalit te treteve,ndryshimin e kohes se veprimtarise,shendrimin e shoqerise ne nje forme tjeter,likujdimin e shoqerise.Sipas akteve ligjore ben shlyerjen e detyrimeve ndaj organeve shteterore,personave juridik ose fizik,vendas e te huaj.

NENI 16

Kontrolli financiar i shoqerise kryhet nga nje ose me shume eksperte kontabel te autorizuar ose te emeruar nga Asambleja e ortakeve me nje afat prej tre vitesh financiare te njepasnjeshme me mundesi riemerimi.

NENI 17

Cdo vit financiar fillon ne 1 janar te cdo viti dhe perfundon ne 31 dhjetor te cdo viti,me perjashtim te vitit te pare ku si fillim eshte data e rregjistrimit te shoqerise.

NENI 18

Llogarite vjetore,inventaret,raporti mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e vecanta te hartuara nga administratoret apo ekspertet kontabel miratohet nga asambleja e ortakeve.Miratimi i dokumentave financiare vjetore behet brenda nje afati 3-mujor,mbas dates se shlyerjes se vitit financiar.

NENI 19

Mbas miratimit te llogarive vjetore dhe vertetimit te ekzistences se fitimit Asambleja e ortakeve vendos ndarjen e fitimeve ndermjet ortakeve sipas pjeseve takuese te sejcilit ne kapitalin themelor te shoqerise, krijon fondin ligjor,por mund te krijojte dhe fonde te tjera.Shoqeria pergjigjet per kontributin fiskal,afatet e derdhjes se sigurimeve shoqerore etj.Ajo ka te drejte te cele llogari likujduese prane Bankave te vendit dhe te kryejte veprimtari likujduese nepermjet tyre.

NENI 20

Veprimtaria ekonomike e shoqerise mbaron ne 31 dhjetor te cdo vitit.Administratori ose personat e caktuar prej tij jane te detyruar te paraqesin bilancin



vjetor dhe deklaraten e te ardhurave e ti depozitojne ne Organin financiar te Zyres se Tatimeve.

NENI 21

Mardheniet e punesimit brenda shoqerise rregullohen nepermjet kontrates se punesimit qe lidhet midis paleve ne perputhje me ligjin 7961 date 12.07.1995 (Kodit te punes) si dhe legjislacionit tjeter shqiptar qe ben fjale per punesimin.

NENI 22

Shoqeria mund te lidhe kontrata me sektore shteterore drejperdrejt ne tregun e lire si dhe me persona juridik ose fizik, vendas ose te huaj.

Ne veprimet kontraktuale shoqeria perfaqesohet nga administratori i shoqerise.

Ajo mund te perfaqesohet edhe nga persona te tjere te emeruar prej tij me prokure.

Te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga kontratat jane te detyrueshme per shoqerine.

NENI 23

Shoqeria mund te prishet para afatit te caktuar ne kete statut ne rastet kur ndryshon afati i veprimtarise se shoqerise me vendim te asamblese te ortakeve ose kur ka shkaqe te tjera qe cojne ne prishje te parakoshme te shoqerise.

Shoqeria hyn ne procesin e likujdimit qe ne momentin e prishjes se saj. Per kryerjen e ketij procesi emerohen nje ose disa likujdatore te cilet ndjekin operacionet e likujdimit deri ne fund dhe i paraqesin asamblese te ortakeve, rrezultatet perfundimtare te likujdimit. Ne perfundim Asambleja e ortakeve vendos per heqjen e mandatit te tyre. Te gjitha detyrimet qe dalin nga akti i likujdimit Asambleja e Ortakeve i merr persiper per ti shlyer me kapitalin e ortakeve te shoqerise te derdhur ne kapitalin themeltar te shoqerise.

NENI 24

Te gjitha mosmarveshjet qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim brenda shoqerise si dhe me te tretet apo midis vete ortakeve do te zgjidhen nepermjet Gjykates se shkalles se pare Tirane.

NENI 25

Ndryshimi i formes se shoqerise ne nje shoqeri me forme tjeter behet me vendim te Asamblese te Ortakeve, kur plotesohen kushtet per krijimin e llojeve te tjera.

NENI 26




Ceshtje te tjera te patrajtuar ne kete statut do te mbeshteten per zbatim ne legjislacionin shqiptar ne fuqi, sipas rastit konkret, si ne ligjin 7512 date 10.08.1991, ligjin 7638 date 19.11.1992, 7667 date 28.01.1993 dhe Kodit Civil si dhe akteve te tjera ligjore dhe nenligjore te dala ne zbatim te tyre.

NENI 27

Shoqeria do te kete vulen e saj.

NENI 28

Statuti eshte hartuar me vullnetin e lire dhe te plote te ortakeve themelues, dhe eshte nenshkruar prej tyre.

Statuti hartohet ne kater kopje per tui shperndare organeve kompetente dhe nje kopie mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise

Tirane me 16.01.2006

ORTAKET

THEMELUES

SHKELQIM GOLLI

Shkelqim Goll


ZELFIJE GASHI

Zelfije Gashi
